

Në bazë të nenit 5 paragrafi (1) të Rregullores së Formimit të Çmimeve të më Larta të Shitjes me Pakicë të Derivateve të Ndryshme të Naftës dhe Lëndëve Djegëse të Transportit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 108/20, 133/20, 49/22, 54/22, 64/22, 125/22, 218/25, 48/26, 60/26 dhe 87/26), Komisioni Rregullator i Energjetikës, i Shërbimeve të Ujit dhe i Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturina Komunale i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 20 maj 2026, solli këtë

Vendim

për përcaktimin e dendësisë së përshkallëzuar ρ_e dhe dendësisë së pashkallëzuar ρ_d , të secilit derivat të naftës dhe të lëndës djegëse për transport, të shumës së kompensimit P për premi, shpenzimet e transportit T deri në depozitë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe shumën e kompensimit D për shpenzimet e punës përmes depozitës dhe marzhës tregtare me shpenzimet e përfshira të transportit nga depozita deri te pikat e karburantit dhe te konsumatorët e fundëm

Neni 1

Me këtë vendim përcaktohet dendësia e përshkallëzuar ρ_e dhe dendësia e pashkallëzuar ρ_d , e secilit derivat të naftës dhe e lëndës djegëse të transportit, shuma e kompensimit P për premi, shpenzimet e transportit T deri në depozitën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe shuma e kompensimit D për shpenzimet e punës përmes depozitës dhe marzha tregtare me shpenzimet e përfshira të transportit nga depozita deri te pikat e karburantit dhe te konsumatorët e fundëm, të cilat do të zbatohen në periudhën nga data 25 maj 2026 deri më 29 nëntor 2026.

Neni 2

- (1) Dendësia e pashkallëzuar ρ_d e secilit derivat të naftës dhe e lëndës djegëse të transportit nga neni 2, paragrafi (1) i Rregullores së Formimit të Çmimeve më të Larta të Shitjes me Pakicë të Derivateve të Ndryshme të Naftës dhe Lëndëve Djegëse të Transportit, me përjashtim të Mazutit M -1 është:
- për benzinë motori EUROSUPER BS – 95 0,743 (kg/l),
 - për benzinë motori EUROSUPER BS – 98..... 0,751 (kg/l) ,
 - për naftë motori - EUROSUPER BS (D-E V) 0,822 (denarë/ litër) dhe
 - për vaj për djegie - Ekstra i Lehtë 1 (EL-1) 0,827 (kg/l),
- (2) Dendësia e përshkallëzuar ρ_e e secilit derivat të naftës dhe lëndës djegëse për transport nga neni 2, paragrafi (1) i Rregullores së Formimit të Çmimeve më të Larta të Shitjes me Pakicë të Derivateve të Ndryshme të Naftës dhe të Lëndëve Djegëse për Transport, me përjashtim të mazutit M -1, është:
- për benzinë motori EUROSUPER BS – 950,755 (kg/l),
 - për benzinë motori EUROSUPER BS – 980,755 (kg/l),
 - për naftë motori - EUROSUPER BS (D-E V) 0,845 (kg/l) dhe
 - për vaj për djegie - Ekstra të Lehtë 1 (EL-1) 0,845 (kg/l).

Neni 3

Kompensimi për preminë (P) për secilin derivat të naftës dhe lëndës djegëse për transport është:

- për benzinë motori EUROSUPER BS – 95 75 USD/t ,
- për benzinë motori EUROSUPER BS – 98117 USD/t,
- për naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V) 55 USD/t ,
- për vaj për djegie - Ekstra i Lehtë 1 (EL-1)..... 56 USD/t dhe
- për mazut M-1..... 88 USD/t.

Neni 4

Kompensimi më i lartë T për shpenzimet e transportit deri te depozita në Republikën e Maqedonisë së Veriut për secilin derivat të naftës dhe lëndës djegëse për transport është:

- për benzinë motori EUROSUPER BS – 95 25 USD/t ,
- për benzinë motori EUROSUPER BS – 98 25 USD/t,
- për naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V)..... 25 USD/t,
- për vaj për djegie - Ekstra i Lehtë 1 (EL-1).....25 USD/t dhe
- për mazut M-1..... 25 USD/t.

Neni 5

(1) Kompensimi më i lartë D për secilin derivat të naftës, përveç për mazut M-1, në shumë totale prej 7,70 MKD/l, përlloraget si shuma e kompensimeve më të larta për shpenzimet e punës përmes depozitës, marzhës tregtare dhe e shpenzimeve për transport nga depozita deri te pikat e karburantit dhe konsumatorët e fundëm, të cilët për secilin derivat të naftës dhe lëndës djegëse për transport veçmas janë:

a) Shpenzimet për punën përmes depozitës:

- 1) për benzinë motori EUROSUPER BS – 951,20 MKD/l,
- 2) për benzinë motori EUROSUPER BS – 981,20 MKD/l,
- 3) për naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V) 1,20 MKD/l dhe
- 4) për vaj për djegie - Ekstra të lehtë 1 (EL-1).....1,20 MKD/l.

b) Marzha tregtare:

- 1) për benzinë motori EUROSUPER BS – 95 5,50 MKD/l,
- 2) për benzinë motori EUROSUPER BS – 985,50 MKD/l,
- 3) për naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V).....5,50 MKD/l dhe
- 4) për vaj për djegie - Ekstra të Lehtë 1 (EL-1).....5,50 MKD/l.

c) Shpenzimet e transportit nga depozita deri te stacionet e benzinës dhe te konsumatorët e fundëm:

- 1) për benzinë motori EUROSUPER BS – 95..... 1,00 MKD/l,

- 2) për benzinë motori EUROSUPER BS – 98.....1,00 MKD/L,
 - 3) për naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V)..... 1,00 MKD/L dhe
 - 4) për vaj për djegie - Ekstra të Lehtë 1 (EL-1).....1,00 MKD/L.
- (2) Kompensimi D për mazut M-1 është 3,00 MKD/kg dhe ai nuk e përmban kompensimin e marzhës tregtare me shpenzimet e përfshira të transportit nga depozita deri te pikat e karburantit dhe te konsumatorët e fundëm..

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e sjelljes së tij, botohet në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” dhe publikohet në faqen e internetit të Komisionit Rregullator të Energjetikës, të Shërbimeve të Ujit dhe të Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturina Komunale të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe do të zbatohet ora 00:01 datë 25 maj 2026.

nr.02-814/1
20 maj 2026
Shkup

**Kryetari i Komisionit Rregullator të
Energjetikës, të Shërbimeve të Ujit dhe të
Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturinat
Komunale të Republikës së Maqedonisë së
Veriut**

Ацо Ристов